



V E N D I M

Nr. 866, datë 10.12.2014

P Ë R

MIRATIMIN E LISTAVE TË TIPEVE TË HABITATEVE NATYRORE, BIMËVE, KAFSHËVE DHE SHPENDËVE, ME INTERES PËR BASHKIMIN EVROPIAN*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17/4, të ligjit nr.9587, datë 20.7.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e listave të tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian, sipas anekseve të mëposhtme, që i bashkëlidhen këtij vendimi:

- a) Aneksi I: Tipet e habitateve natyrore me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;
- b) Aneksi II: Llojet e bimëve dhe kafshëve me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;
- c) Aneksi III: Lloje kafshësh dhe bimësh me interes për Bashkimin Evropian, në nevojë për mbrojtje strikte;

* Ky vendim përaftron plotësisht:

1. Aneksin I, II, IV dhe V, të direktivës 92/43/EEC, për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e eger, të ndryshuar nga direktiva 97/62/EC, direktiva 2006/105/EC dhe rregullorja (EC) 1882/2003 (Fl. L 206, 22.7.1992, fq. 7);
2. Aneksin V të direktivës 2009/147/EC për ruajtjen e shpendëve të egër (FZ. L20/7, 20.1.2010.).

- ç) Aneksi IV: Llojet e kafshëve dhe bimëve me interes për Bashkimin Evropian, kapja në gjendje të egër, shfrytëzimi i të cilave mund të jetë objekt i masave menaxhuese;
- d) Aneksi V: Parimet për identifikimin e llojeve të shpendëve të egër që do të jenë objekt kërkimi për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I MJEDISIT

LEFTER KOKA